



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
TEPELENË

Nr. 615 *Pres*

Tepelenë më 28.03, 2025

P/V E N D I M

Nr. ____ .Datë. ____ .03.2025

PËR

“Përcaktimin e vendndodhjes së terminalit të autobuzëve në Bashkinë Tepelenë”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 6 dhe 14, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 21/1, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 për “Transportet Rrugore” (i ndryshuar); nenit 12, të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për “Planifikimin e Territorit” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë vendndodhjen e terminalit të transportit të autobuzëve në Bashkinë e Tepelenës sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi si Aneksi nr.1.
2. Të ngarkojë strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Tepelenës të për sistemimin dhe përgatitjen e vendit të terminalit për qëndrimin e autobuzëve.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT).
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Jurist

KRYETAR

Arben Gumeni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË

Tepelenë më, 21.03.2025

RELACION

“ Për Përcaktimin e vendndodhjes së terminalit të autobuzëve në Bashkinë Tepelenë”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Tepelenë.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 6 dhe 14, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 21/1, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 për “Transportet Rrugore” (i ndryshuar); nenit 12, të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për “Planifikimin e Territorit” (i ndryshuar), kërkesave/ankesave të subjekteve private që ushtrojnë aktivitetet të licencuar si taksi në qytetin e Tepelenës;

PROPOZOJMË:


Miratimin e vendndodhjes e terminalit të transportit të autobuzëve në Bashkinë e Tepelenës sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi si Aneksi nr.1., Zona Kadastrale nr. 3574, pasuria nr.8/64, sipas planvendosjes bashkëlidhur, prone në inventar të Bashkisë Tepelenë.

Grupi i Punës:

1. Maksim Shehu

2. Gëzim Shehu

3. Florenc Korça



SHK. 1:500



34

18/11/2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

18/01/2011
gab. 100

V E N D I M

Nr. 6, datë 6.1.2011

P Ë R

**MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE,
QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË BASHKISË TEPELENË, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Tepelenë, të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1367 (një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë).



2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM

LULZIM BASHA



Bashkia Tepelenë

Lidhje 1

Nr. rendorë i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-17	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
18-23, 67-72, 145-238, 240-415, 416-1156 (vetëm sheshet dhe lulishtet)	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
31-52	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
53-66, 73, 74-77, 93-108	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive.	Në pronësi
109-134	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
142-144	Varrezat publike.	Në pronësi
416-1156 (vetëm troje të lira)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
1183	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë.	Në pronësi
1357	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive).	Në pronësi
1358	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

MINISTRI

LULZIM BASHA



3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Troje dhe Sheshe Bashkia Tepelene	Shesh Fush Tepelene	Bashkia Tepelene	404	Infrastrukture vendore	Bashkia Tepelene	Bashkia Tepelene	
933	3574 E - 6	8/55		"	"	94	"	"	"	
934	3574 E - 6	8/57		"	"	238	"	"	"	
935	3574 E - 6	8/52		"	"	150	"	"	"	
936	3574 E - 6	8/64		"	"	160	"	"	"	
937	3574 E - 6	8/65		"	"	478	"	"	"	
938	3574 E - 6	8/69		"	"	64	"	"	"	
939	3574 E - 6	8/71		"	"	242	"	"	"	
940	3574 E - 6	8/75		"	"		"	"	"	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.616 prot.

Tepelenë, më 28.03.2025

Njoftim për konsultimin publik

Titulli dhe kodi i projektaktit:

Për përcaktimin e vendndodhjes së terminalit të autobuzëve në Bashkinë Tepelenë.

Takimi publik:

Konsultimet publike do të organizohen , sipas kalendarit bashkëlidhur këtij njoftimi.

Të ftuar:

Të gjithë banorët e territorit të Bashkisë Tepelenë, përfaqësues të shoqërisë civile, grupe interesi, OJF, Media, Kryetarët e fshatrave dhe ndërlidhësit komunitarë, grupe vulnerabël, përfaqësues të shoqatës së personave me aftësi të kufizuar etj.

Pjesëmarrës nga bashkia:

Kryetare e Bashkisë, Kryetari i Këshillit Bashkiak, Këshilltarë të Këshillit Bashkiak. Sekretarja e Këshillit bashkiak, Koordinator për Informim dhe Konsultim Publik, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menazhimit Financiar, Drejtoria Ligjore dhe Shërbimeve Organizative, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Zhvillimit Rural, Administratorë të Njërive Administrative, Kryetarët e fshatrave.

Drejtuesi i takimit publik

Kryetare e Bashkisë Tepelenë Znj.Julinda Karteri

Nr.	Informacioni për publikun	Përshkrimi
1	Qëllimi i këshillimit publik	Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 18, dhe nenit 54 shkonja “e” të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak për Konsultimet Publike, ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin publik” Këshilli Bashkiak Tepelenë njofton se do të organizoj seancë këshillimi me publikun për diskutimin lidhur me p/vendimin për “Përcaktimin e vendndodhjes së terminalit të autobuzëve në Bashkinë Tepelenë”
2	Përshkrimi i çështjes që trajton projektakti	Dëgjese me publikun mbi Projektvendimin e propozuar, që Këshilli Bashkiak të marrë vendim "Për përcaktimin e vendndodhjes së terminalit të autobuzëve në Bashkinë Tepelenë”
3	Projektakti dhe relacionin shoqërues	Materiali i ngarkuar në https://tepelena.gov.al/
4	Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	Me qëllim për të orjentuar (por jo kufizuar) mendimet dhe sygjerimet tuaja këshilli ngre për ju disa pyetje për të dhënë mendime në mënyre që të jetë sa më i qartë sygjerimi juaj dhe rrjedhimisht vendimarrja e Këshillit - A jeni dakort me përcaktimin e vendndodhjes së terminalit të autobuzëve në Bashkinë Tepelenë për të ndihmuar lëvizjen e qytetarëve? Cilat janë sugjerimet tuaja për të përmirësuar/ndryshuar këtë draft projektvendim? Cfarë konsideroni se duhet shtuar në këtë draft projektvendim?
5	Grupet e interesit, strukturat komunitare me të cilat do të konsultohet projektakti	Qytetarë të Bashkisë Tepelenë, dhe Njësi Administrative.
6	NjA, lagjet, fshatrat ku do të mbahen takimet publike apo që ftohen të dërgojnë komente dhe rekomandime	Bashkia Tepelenë, sipas kalendarit bashkëlidhur.
7	Kalendari i takimeve dhe dëgjësive publike	Kalendari i datës vendit dhe orës është i përcaktuar në kalendarin bashkëlidhur këtij njoftimi. Për cdo lloj komunikim jeni të lutur të kontaktoni nëpërmjet e-mailit info@tepelena.gov.al
8	Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve dhe rekomandimeve	Komentet dhe rekomandimet tuaja i mirëpresim brenda datës 10 /04/2025: 2. Nëpërmjet pjesëmarrjes tuaj në takimin publik , apo mund t'i dërgoni me e-mail në adresën: Valbona.Cela@tepelena.gov.al ose nëpërmjet postës në <u>adresën</u> Keshilli.Bashkiak@tepelena.gov.al , Sheshi “Lord Bajron”, Kodi postar 6301

9	Çfarë do të vijojë pas kësaj faze këshillimi	Pas përfundimit të këtij konsultimi publik, Këshilli Bashkiak do të dërgojë tek Kryetari i Bashkisë dhe drejtoritë përkatëse një shkresë, me të gjitha rekomandimet e nxjerra nga kjo dëgjese publike.
---	--	--

KALENDARI I ZHVILLIMIT TË KONSULTIT PUBLIKE ME QYTETARËT E BASHKISË TEPELENË

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE	DATA	ORA	VENDI
1	Qytet Tepelenë	14.04.2025	10:00	Bashkia Tepelenë (Kati i dytë)

KRYETARI I KËSHILLIT

Arben GUMENI

